



dita kombëtare e aktivizmit



Vepro kudo je, dhe si mundesh. Bashkoju #NAD2021

Në morinë e problemeve dhe sfidave të përditshme, gjenden dhe hapësirat e mundësitë për të kërkuar dhe arritur ndryshime të prekshme. Mundësia për të provuar, dhe për të mos hequr dorë është një pushtet i prekshëm në duart e njerëzve të zakonshëm, të cilët kur guxojnë, mund të formëzojnë ndryshime të jashtëzakonshme.

Ndaj këtë 22 tetor, pavarësisht ku ndodheni dhe çfarë nisme keni për zemër, bashkohuni me Ditën Kombëtare të Aktivizmit #NAD2021!

Bashkohuni #NAD2021 - si një organizatë e re, një grup entuziast, apo dhe një individ plot energji kudo në Shqipëri me çfarëdo aktivitet apo nisëm ju mendoni që mund të sjellë një shembull të mirë aktivizmi dhe qytetarie!

#NAD është një ditë dedikuar njerëzve dhe nismave që guxojnë dhe përfshihen për të përmirësuar gjërat që shqetësojnë shoqërinë. Pavarësisht formës dhe gjeografisë, #NAD na sjell bashkë për të na kujtuar që ne mundemi të bëjmë ndryshim.

1. Zgjidhni ndërmjet:

(a) Pjesëmarrjes në Panairin e Aktivizmit në Tiranë përmes një nisme/historie suksesi të punës tuaj në aktivizëm ose vullnetarizëm. Për të marrë pjesë në këtë panair, jeni të lutur të shprehni interesin paraprakisht përmes formatit bashkëngjitur kësaj thirrje - si individ, grup individësh, apo organizatë. Do të përzgjidhen të marrin pjesë në panair ato nisma të cilat do të prezantohen në një mënyrë krijuese dhe sa më të prekshme.

b) Një aktiviteti të organizuar nga ju në një komunitet kudo në Shqipëri, si nisëm e lirë, apo pjesë e ndonjë nisme apo projekti ekzistues. Forma, vend-ndodhja dhe mënyra përcaktohen nga ju.

(c) ose të dyja.

2. Konfirmoni pjesëmarrjen brenda dt. 10 Tetor në co-plan@co-plan.org dhe aida_ciro@co-plan.org. Për çdo pyetje, mund të na kontaktoni në 0696089130.

#NAD është një nisëm e përvitshme e Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë.

Ju mirëpresim!



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

